




gorenje




1.




2.










3.



4.





I nderuar klient,

Keni blerë një produkt nga linja jonë e re e produkteve shtëpiake. Është dëshira jonë, që produkti jonë t'ju shërbejë sa më mirë.

Përpara instalimit dhe përdorimit të mjetit shtëpiak lexoni këtë udhëzim përdorimi. Përmban informacione të rëndësishme, se si të përdorni në mënyrë të sigurtë dhe ekonomike aparaturën shtëpiake. Udhëzimin ruajeni së bashku me aparaturën shtëpiake për përdorim tjetër të mundshëm.

Udhëzimin për përdorimin mund ta gjeni po ashtu tek faqet e internetit:

www.gorenje.com / <<http://www.gorenje.com>>



Informacione të rëndësishme



Ide, shënime

PËRMBATJA

6	INFORMATA TE RENDESISHME INSTRUKSIONE DHE REKOMANDIME	HYRJA DHE PËRSHKRIMI
9	PERSHKRIMI DHE PERDORIMI I PAJISJES ELEKTROSHTETIAKE	
12	PËRDORIMI I PAJISJES NGROHËSE	PËRDORIMI
15	LIKUIDIMI I PAJISJEVE PAS KONSUMIMIT TE TYRE	MIRËMBAJTJA DHE REKLAMIMI
16	PASTRIMI DHE MIREMBAJTJA	
17	REKLAMAMI	
18	LIDHJA E PAJISJES ELEKTROSHTETIAKE ME RRJETIN ELEKTRIK	INSTALIMI
19	UDHEZIMET PER INSTALIM	
20	Ç'TË BËJMË KUR PAJISJA NGROHËSE NUK FUNKSIONON	
21	TE DHENAT TEKNIKE	TË DHËNAT TEKNIKE

INFORMATA TE RENDESISHME

ISTRUKSIONE DHE REKOMANDIME

MASA SIGURIE



Fëmijët e moshës tetë vjeçare e më shumë dhe personat me kapacitet të dobët fizik, sensorik dhe mental ose me njohuri dhe eksperiencë të mangshme, mund të përdorin aparatin në fjalë nën mbikqyrje adekuate ose në qoftë se kanë marrë udhëzime të përshtatshme sa i takon përdorimit të aparatit dhe në qoftë se i kuptojnë rreziqet lidhur me përdorimin e aparatit. Nuk lejohet që fëmijët të pastrojnë aparatin dhe të ndërmarrin veprime për mirëmbajtje në të, pa mbikqyrje adekuate.

Para lidhjes kontrolloni, në qoftë se të dhënat për tensionin në lidhjen që duam, të cilat janë vendosur në etiketën e mjetit, përputhen apo jo me tensionin e rrjetit tuaj shpërndarës. Aparatin mund ta lidhi me rrjetin elektrik vetëm tekniku i servisit ose personi me përgatitjet e duhura profesionale.

Instalimin mund ta bëjë personi i përgatitur nga ana profesionale dhe instalimi duhet të bëhet në përputhje me normat dhe udhëzimet. Prodhuesi nuk ka përgjegjësi për dëmtimin e aparatit ose të shëndetit si pasojë e gabimeve të montimit ose lidhjes.

Datën e kryerjes së instalimit shënojeni në fletën e sigurisë.

Prodhuesi nuk mban përgjegjësi për dëmtimin e pajisjes ose dëmtimet e lindura gjatë përdorimit jo të rregullt ose dëmtimin e sistemit mbrojtës të rrjetit elektrik (p.sh. me kalimin e tensionit).

Mjetin përdoreni pas futjes së tij në raft.

Kujdes! Asnjë herë mos e çmontoni mbulesën e pajisjes. Kontakti i rastësishëm me pjesën nën tension, tregon rrezik sigurie për përdoruesit.

Kujdes! Gjatë ç'do montimi ose ç'montimi të pajisjes, përveç përdorimit të zakonshëm, duhet që pajisjen ta shkëpusim nga rrjeti elektrik dhe të sigurohet gjendja e saj e fikur. Gjatë ç'takimit të pajisjes dueht të plotësohet njëri nga kushtet e më poshtme.

- shkëpusni siguresën ose lidhjen në raftin shpërndarës.
- futësin tërhiqeni nga priza. Gjatë shkëputjes së futësit nga priza mos e tërhiqni nga kablli elektrik, por gjithmonë tërhiqeni direkt nga futësi.

Manipulimi me pajisjen ose servisi jo profesional mund të çojë në rrezikun e plagosjes së rëndë, ose të dëmtimit të shëndetit ose të pajisjes. Instalimin, të gjitha riparimet, rregullimet dhe ndërhyrjet në pajisje duhet të bëhen gjithmonë nga tekniku i servisit ose personi i përgatitur nga ana profesionale. Prodhuesi nuk merr përgjegjësi për plagosjen e personave ose dëmtimet e krijuara me manipulimin jo të përshtatshëm ose ndërhyrjen jo profesionale në pajisje.

Lidhësi i ushqyesit të dëmtuar duhet të zëvendësohet nga tekniku i servisit ose nga personi i përgatitur profesionalisht, që të mund të parandalojmë lindjen e situatave të rrezikshme.

Në se në periudhën e garancisë në pajisje shfaqet ndonjë dëmtim, atë mos e riparoni vetë. Largojeni mjetin nga puna dhe për riparim thërrisni njeriun përgjegjës për këtë punë. Në rast se nuk i përmbaheni udhëzimeve dhe rekomandimeve të vëna në këtë mënyrë përdorimi, prodhuesi nuk përgjigjet për dëmtimin e shkaktuar.

Pajisja është caktuar vetëm për përdorim shtëpijak!

Përdorimi jo i rregullt i pajisjes mund të rrezikojë përdoruesin.

Pajisjen përdoreni vetëm për ngrohjen e enës, mbajtjen e ushqimit në gjendje të ngrohtë, përgatitjen e koseve etj. Çdo përdorim tjetër nuk është i lejueshëm dhe mund të jetë i rrezikshëm. Prodhuesi nuk mban asnjë përgjegjësi për rënien ose dëmtimet, që ndodhin si pasojë e përdorimit jo të përshtatshëm ose jo të rregullt të mjetit.

Në varësi të temperaturës së zgjedhur dhe të kohës së punës temperatura brenda pajisjes mund të arrijë deri në 80°C. Gjatë heqjes së enës nga priza përdorni dorezat e kuzhinës ose fshirësen e enëve.

KUJDES ! Pajisja dhe pjesët e dukura gjatë përdorimit bëhen të nxehta.

Mos lejoni fëmijët nën 8 vjeç të afrohen, nëse nuk janë nën vëzhgimin e prindërve.

Tek lidhësi i hapur mos u ulni, mos u mbështetni, sepse mund të dëmtoni mekanizmin lidhës.

Mbajtja maksimale e lidhësit është 30 kg.

PARALAJMËRIM! Rrezik zjarri: Mos veni enë sintetike ose objekte që ndizen tek lidhësi i brendëshëm që ngroh. Pas ndezjes së pajisjes këto enë dhe objekte mund të shkrihen ose ndizen.

Pajisjen mos e përdorni për qëllime të tjera, p.sh. për ngrohjen e mjedisit. Temperaturat e larta mund të shkaktojnë ndezjen e objekteve ndezës në afërsi të pajisjes.

Gjatë pastrimit të pajisjes asnjë herë mos përdorni pastrues me avull apo presion. Ka rrezik të prekeni nga rryma elektrike. Avulli mund të dëmtojë pjesët elektrike dhe të shkaktojë qark të shkurtër. Shtypja e avullit mund të shkaktojë dëmtim të përhershëm të sipërfaqes së pajisjes dhe pjesëve të tij.

Kur të pushoni përdorimin e pajisjes, p.sh. në fund të jetëgjatësisë së tij, çlidheni atë nga rrjeti elektrik dhe largoni kabllin ushqyes, që pajisja të mos jetë e rrezikshme.

QËLLIMI I PAJISJES

Pajisja është caktuar për përgatitjen e zakonshme të ushqimeve në shtëpi dhe nuk duhet të përdoret për qëllime të tjera. Mundësitë e ndryshme të përdorimit të tij janë paraqitur në mënyrë të plotë në këtë manual.

PERSHKRIMI DHE PERDORIMI I PAJISJES ELEKTROSHTETIAKE

Pajisja është caktuar për ta vendosur atë tek pajisja e kuzhinës dhe është caktuar për ngrohje të enëve, çngirirje, mbatjen e ushqimit në gjendje të ngrohtë dhe përgatitjen e koseve.


Për ngrohje shfrytëzohet sistemi i ajrit të ngrohtë, i cili me ndihmën e ventilatorëve e çon ajrin e ngrohtë tek hapësirat e pajisjes. Në sajë të qarkullimit të ajrit, enët ngrohen barazisht dhe shpejt. Megjithatë enët e vendosura në pjesën mbrapa të pajisjes mund të jenë më të nxehta se sa ato pjesë të përparme.

Paneli komandues përmban sensorët komandues me programe të paracaktuara dhe me modin e manipulimit, që mundëson zgjedhjen e kërkuar të temperaturës në shtrirjen 40-80°C (në hapa me 10°C) dhe fikjen automatike pas arritjes së kohës së ngrohjes (1-4 orë).

Pajisja ngrohet vetëm atëhere, nëse priza është e mbyllur mirë.

ELEMENTËT KOMANDUES

Komandimi me anë të sensorëve aktivizohet me vendosjen e gishtit në shenjë e caktuar tek paneli komandues. Prandaj panelin komandues mbajeni në gjendje të pastër dhe të thatë.



Senzori i ndezjes dhe i fikjes

Ngrohja e pjatave
Ngrohja e filxhanëve
Mbatja e ushqimit të ngrohtë
Përgatitjen e koseve
Shkrirja

Rregjimet automatike

Vendosja me dorë
Vendosja e temperaturës së kërkuar
Vendosja e kohës së ngrohjes

Rregjimet manuale

PËRPARA PËRDORIMIT TË PARË

Para përdorimit të parë pastrojeni pajisjen, sipas udhëzimeve të vendosura në kapitullin „Pastrimi dhe Mirëmbajtja“.

Pas kësaj lejeni pajisjen ngrohëse të paktën 2 orë të ngrohet deri në temperaturën maksimale. Gjatë kësaj procedure kini kujdes, që kuzhina të jetë e ajrosur mirë. Pjesët e pajisjes janë të mbrojtura me një mjet të veçantë, prandaj pajisja gjatë ngrohjes së parë lëshon erë të keqe. Kjo erë e keqe ose tym, i cili mund të shfaqet, ai zhduket për një kohë të shkurtër. Në asnjë rast nuk do të thotë, që pajisja dhe lidhja e saj nuk janë në rregull.

Kapaciteti

Kapaciteti mund të ndryshojë në rast të përdorimit të madhësisë së enës.

Shembuj orientues të kapacitetit

Kompleti i shërbimit për 6 vetë

6 pjata të sheshta	ø 25,5 cm
6 pjata të thella	ø 22 cm
6 pjata ëmbëlsirash	ø 23,5 cm
1 pjatë ovale	gjerësi 32 cm
1 pjatë servirje	ø 19,5 cm
1 pjatë servirje	ø 18,5 cm

Mbajtja maksimale e lidhësit është 30 kg.

PËRDORIMI I PAJISJES NGROHËSE

Mjetin hapeni me një shtypje të lehtë në panelin e përparëm. Vendosni enën dhe zgjidhni programin përkatës ose zgjidhni vendosjen me dorë dhe vendosni kohën dhe temperaturën e ngrohjes. Mbylleni prizën duke e shtypur tek pjesa ballore e pajisjes. Pas mbylljes fillon ngrohja.

Pas kalimit të kohës së ngrohjes sistemi ndalon dhe jep sinjal me zë. Ky sinjal tingëllon një minut dhe më pas jepet sinjali me zë, gjithmonë pas një minute. Pas pesë minutash pas vendosjes së programit të caktuar priza fiket.

Nëse doni të ndërprisni vazhdimin e programit, hapeni pajisjen dhe shtypni senzori e fikjes. Pas hapjes së pajisjes mund të zgjidhni program tjetër ose zgjasni kohën e ngrohjes.

Shënim

Me ndërhyrjen në rregjimin automatik programi kthehet në rregjimin me dorë. Këtë ndërhyrje nuk mund ta bëjmë tek programi për koset.

Koha e ngrohjes

Në kohën e ngrohjes ndikojnë disa faktorë:

Materiali dhe trashësia e enës,
Sasia e enëve që do të ngrohen,
Mënyra e shpërndarjes në pajisje,
Vendosja e temperaturës

Për këtë arsye ngrohja e plotë e enës mund të zgjasë një kohë më të gjatë. Vendosja e programeve në këtë pikëpamje ka vetëm karakter orientues. Pas një kohe të caktuar vetë do të gjeni kohën ideale të ngrohjes për enët tuaja.

Enët e vendosura në pjesën mbrapsht të hapësirës të mjetit mund të jetë më e ngrohtë sesa ajo në pjesën e përparme. Gjatë nxjerrejs së enës nga mjeti përdorni doreza kuzhine ose shamitë e kuxhinës.

PËRDORIMI I PAJISJES NGROHËSE

Ndezja e mjetit

Ndizeni mjetin duke shtypur sensorin përkatës.



RREGJIMET AUTOMATIKE

Ngrohja e pjatave

Zgjidhni rregjimin e Ngrohjes së Pjatave.



Ky rregjim automatik e ka të parapërcaktuar **temperaturën në 80°C** dhe kohën për tu ngrohur **1 orë**. Është i caktuar për të ngrohur paraprakisht enën përkatëse për të ofruar ushqimin. Enët e parangrohura mbajnë temperaturën e ushqimit të servirur.

Ngrohja e filxhanëve

Zgjidhni rregjimin Ngrohja e Filxhanëve.



Ky rregjim automatik e ka temperaturën të paravendosur **në 60°C** dhe kohën për tu ngrohur **1 orë**. Është i përcaktuar për ngrohjen e filxhanëve të caktuar për përgatitjen e pijeve të ngrohta p.sh. ekspresin. Filxhanët e parangrohur sigurojnë shkumë më të qëndrueshme të ekspresit.

Mbajtja e ushqimeve të ngrohta

Zgjidhni rregjimin Mbajtja e Ushqimit të Ngrohtë



Ky rregjim automatik e ka **temperaturën** e vendosur në **60°C** dhe kohën për tu ngrohur **2 orë**. Është caktuar për të mbajtur gjendjen e nxehtësisë së ushqimit të vendosur në enë ose tek pjatat për të ofruar ushqim të servirur.

Kosi

Zgjidhni rregjimin Kosi.



Ky rregjim e ka temperaturën e vendosur **40°C** dhe kohën e ngrohjes **4 orë**. Është i caktuar për përgatitjen e koseve. Proçedura kërkon vendosjen e saktë të temperaturës dhe vendosjen e saktë të kohës, prandaj gjatë këtij rregjimi këto vlera nuk mund të ndryshohen.

Tipi: Përgatitja e Koseve

1 litër qumësht të freskët me gjysëm sasi yndyre ngroheni në temperaturën afërsisht 80°C dhe pas kësaj e lejme të ftohet deri në temperaturën 40°C. Në qumësht hedhim dy lugë me kos të bardhë dhe kulturë të gjallë. Qumështin e hedhim tek gotat për kos. Gotat duhet të jenë krejtësisht të pastra, më mirë të sterilizuara. Gotat i vendosim në mes të pajisjes. Mos i veni gotat më afër se 10 cm nga muri i prapëm i pajisjes. Midis gotave lejme pak boshllik, që të qarkullojë ajri. Zgjidhni regjimin Kosi. Pas 4 orësh programi ka mbaruar, lejeni kosin edhe dy orë në pajisje, por pa ngrohje. Pas qëndrimit 10 orë të kosit në frigorifer, kur gjatë kësaj kohe do të vijë i plotë, kosi do të jetë gati.

Shkrirja

Zgjedhim rregjimin Shkrirja.



Ky rregjim automatik e ka temperaturën e vënë në **40°C** dhe kohën e ngrohjes **2 orë**. Është i caktuar për shkrirje të ushqimeve të ngrira. Ushqimet e ngrira i fusin në një enë ose pjatë të thellë, që të sigurohet nga kapja e ujit nga shkrirja.

RREGJIMET MANUALE

Zgjidhni Vendosja me Dorë.



Zgjidhni nxehtësinë e duhur me shtypje të përsëritura të sensorit të nxehtësisë.



Temperatura mund të vihet midis 40-80°C duke e ndryshuar atë me 10°C.
Temperatura e vendosur shfaqet në displejin e temperaturës.



Zgjidhni kohën e kërkuar për ngrohje.



Koha mund të vendoset në kufijtë 1-4 orë duke bërë ndryshimin me 1 orë.
Koha e vendosur shfaqet në displej.



Siguresa për Fëmijët

Siguresa për fëmijët shërben për të kufizuar manipulimin e pajisjes nga fëmijët.
Përkufizimi i përdorimit të pajisjes nga fëmijët aktivizohet me shtypjen e sensorit Vendosja me Dorë për 5 sekonda.



Pas kësaj sensorët qëndrojnë jo aktivë. Ndriçon vetëm shenja Vendosja me Dorë. Deaktivizimin e realizoni përsëri duke shtypur sensorin Vendosja me Dorë për kohën 5 sekonda.

Fikja e pajisjes

Pajisja fiket me shtypjen e sensorit për fikje.



Pajisja automatikisht fiket me kalimin e kohës së ngrohjes.

LIKUIDIMI I PAJISJEVE PAS KONSUMIMIT TE TYRE



Simboli tek produkti ose në ambalazhin e tij tregon, që ky prodhim nuk përket tek mbeturinat shtëpiake. Atë duhet ta çoni në vendin e grumbullimit për riciklimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike. Duke siguruar likuidim të rregullt të këtij produkti ju ndihmoni në parandalimin e pasojave negative për mjedisin dhe shëndetin e popullit, të cilat ndryshe do të ndodhin me likuidimin jo të rregullt të këtij prodhimi. Informim më të imët mbi riciklimin e këtij prodhimi e siguroni tek zyrat përkatëse vendore, shërbimet për likuidimin e mbetjeve shtëpiake ose në dyqanin, ku e keni blerë prodhimin.

Mbështjellësi është 100% prej materiali të riciklueshëm dhe ka të shënuar shenjën e riciklimit. Asnjë pjesë të materialit mbledhës mos e hidhni me plehrat e shtëpisë, por likuidojeni atë në përputhje me udhëzimet vendore në fuqi.

Njoftim i rëndësishëm!

Për të pastruar pajisjet asnjë herë mos përdorni pastrues me avull ose presion. Për heqjen e xhamit të brendshëm përdorni pjesët nga ato që e shoqërojnë (fig. 4).

Sipërfaqen pastrojeni me copë të lagët. Nëse është shumë pis, fusni në ujë disa pika lëngu për enët. Në fund fshijeni me copë të thatë.

Anën ballore prej xhami pastrojeni me pastrues për xhama dhe me copë. Mos përdorni gërryese xhami.

Mos përdorni as: pastrues me përmbajtje sode, acidi ose kloridi, mjete gërryese (pluhur ose pastë), sfungjer abraziv (p.sh. gërryersen e enëve), ose sfungjer që përmban mbeturina abrazive, mjete larëse, që shkrinjnë gëlqerorin, mjete larëse për makinat larëse, spreje për pastrimin e sobave.

REKLAMIMI

Nese ne kohe e garancise ndodh nje defekt mos e rregulloni vete. Reklamimin zbatoheni ne dyqanin qe e blete, apo tek servisi i njohur apo ne servise te tjera, te dhena ne garancine. Gjate Hermes se reklamimit zbatoni tekstin e garancise dhe kushtet e saj. Pa paraqitjen e nje garancie te plotesuar eshte reklamimi i pavkefshem.

LIDHJA E PAJISJES ELEKTROSHTETIAKE ME RRJETIN ELEKTRIK

Lidhjen e pajisjes me rrjetin elektrik duhet ta bëjë vetëm firma profesionale në përputhje me normat dhe rregullat vendore.


Për shkëputjen nga rrjeti duhet që tek shpërndarësja para pajisjes të vendoset një mjet për të çlidhur të gjitha polet e mjetit.

Kjo detyrë bie nëse kabli i lidhes ka një grip dhe me këtë mund që theksat dhe pa pengesë ta heqim prej prize.

Mjeti është i pajisur me kabëll 3 fijor me prerje 1,5 mm të tipit H05VV-F 3G1,5. Fundet e përcjellësit janë të përforuara kundra çthurjes me funde të shtypura.

Mjeti duhet të jetë i lidhur me rrjetin elektrik me tensionin e përcaktuar të vendosur në etiketë, që i përgjigjet kapacitetit të pajisjes ngrohëse.

KYÇJA



1. Kapaku prej heqjes se kabllit
2. Fundi i percjellesit te fiksuar

UDHEZIMET PER INSTALIM

Gjate instalimit te paajisjes elektroshtepiake eshte e nevojshme te kruhem eto detyra fillimisht:

Kontrolli i lidhjes me rrjetin.

Kontrollin e e funksioneve të trupit nxehtës, ventilatorëve dhe elementeve të komandimit.

Realizimi para klientit i te gjitha funksioneve te pajisje, dhe njohja me perdorimin e saj dhe mirembajtjen.

NJOFTIM I RENDESISHEM!

Gjatë çdo manipulimi me mjetin përveç përdorimit të zakonshëm duhet të sigurohet shkëputje e tij nga rrjeti elektrik i shëpërndarjes, heqjen e pirunit nga priza ose fikjen e siguresës para pajisjes.



Pajisja nuk është e përgatitur për tu komanduar me ndihmën e kohëmatësve të jashtëm dhe sistemeve të tjerë të veçanta.

Ç'TË BËJMË KUR PAJISJA NGROHËSE NUK FUNKSIONON?

KUJDES! Të gjitha riparimet duhet të bëhen vetëm nga tekniku i servisit ose personi i përgatitur nga ana profesionale. Kryerja e riparimeve nga persona të pa autorizuar është e rrezikshme.

Në rastet të dëmtimeve të vogla, në fillim sigurohuni në se atë sipas udhëzimeve tona mund ta rregulloni vetë.

Enët nuk ngrohen mjaftueshëm

Kontrolloni, nëse:

- pajisja është e ndezur,
- është vendosur temperatura e duhur,
- muri i prapëm i mjetit nuk është i mbushur plot me enë,
- enët ngrohen gjatë kohës së nevojshme.

Koha e ngrohjes varet nga faktorë të ndryshëm, midis të cilëve janë:

- materiali dhe trashësia e enës,
- sasia e enëve,
- mënyra e shpërndarjes së enëve.

Enën nuk ngrohen fare.

Kontrolloni, nëse:

- nuk është shkrirë siguresa ose është fikur siguresa në rrjetin shpërndarës,
- dëgjoni zhurmën e ventilatorëve.

Nëse ventilatori është në gjëndje pune, defekti është në rrjetin e nxehtësisë.

Dëmtimi i sensorit të nxehtësisë sinjalizohet nga fikja/ndezja e displejit të temperaturës dhe ndërprerje të tonit. Pas kësaj pajisja fiket automatikisht.

TE DHENAT TEKNIKE

TE DHENAT TEKNIKE		
PAJISJA NGROHËSE	WD1410X WD1410B	WD1410WG WD1410BG
Permasat	560 x 595 x 140 mm	
Fuqija elektrike í	220-230 V ~; 50/60 Hz	
Fuqija elektrike ne pergjithsi	410 W	

SAP 542586



Prodhesi ruan te drejten e ndryshmit te vogel ne udhezim, qe rrjedhin nga ndryshimet teknologjike dhe inovative te produktit, qe nuk kane ndikim ne funksionin e produktit.

gorenje

GORENJE gospodinjski aparati, d.o.o
Partizanska cesta 12, SI-3320 Velenje, SLOVENIA
info@gorenje.com

